



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2019, ora **10:00**

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Seancë dëgjimore me institucionin e Presidencës

Seancë dëgjimore me ILDKPI-në

Seancë dëgjimore me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit

Seancë dëgjimore me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Seancë dëgjimore me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të

Dhënave

Seancë dëgjimore me Komisionerin e Mbikqyrjes së Shërbimit Civil

Seancë dëgjimore me Autoritetin Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Seancë dëgjimore me Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, , Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Aurora Mara, Elda Hoti, Elena Xhina, Adriatik Alimadhi, Andi Përmeti, Nikolin Staka dhe Artemisa Malo.

Mungojnë:

Korab Lita, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Alban Zeneli, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Ornela Zonja - Sekretare e Përgjithshëm në Presidencën e Republikës

Petra Milo - Këshilltar i Presidentit të Republikës

Bledar Dervishaj - Këshilltar i Presidentit të Republikës

Arti Çiçolli - Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Mirëmenaxhimit Financiar në Presidencën e Republikës

Vilma Çausholli - Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave

Mimoza Dhembli – Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Financave

Fram Brahimaj – përfaqësues nga Ministria e Financave

Flori Karaj - Inspektor në ILDKPI

Evgjeni Bashari - Sekretare e Përgjithshme në ILDKPI

Ylli Merkaj – Sekretar i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Mirela Gega – Drejtoreshë e Financës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Fatbardh Zenelaj - Sekretar i Përgjithshëm pranë zyrës së Avokatit të Popullit

Vilma Shurdha – Komisionere pranë zyrës së Avokatit të Popullit

Ilirian Lole - Përgjegjës i Sektorit të Financës pranë zyrës së Avokatit të Popullit

Ermonela Xhafaj - Komisionere pranë zyrës së Avokatit të Popullit

Robert Gajda - Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ana Muça – Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Erion Lili - Specialist Finance-Buxhet i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Besnik Dervishi - Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Lindita Morina – Drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financës pranë zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Pranvera Strakosha - Komisionere e Mbikqyrjes së Shërbimit Civil

Ollga Hodaj – Drejtoreshë e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë zyrës së Komisionerit të Mbikqyrjes së Shërbimit Civil

Gentiana Sula - Kryetare e Autoritetit Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Simon Mirakaj – Anëtar i Autoritet Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Marenglen Kasmi – Anëtar i Autoritetit Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Altin Hoxha – Anëtar i Autoritetit Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Skënder Vrioni – Sekretar i Përgjithshëm i Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Vitori Fuqi – Përgjegjëse e Sektorit të Financave i Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Mirela Lame – Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve i Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Nevila Turdiu – Sekretare e Kryetares së Autoritetit Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Zoica Graçi - Financiere në Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Jemi në vazhdimësi të seancës që zhvilluam dje me bllokun e parë të institucioneve, që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve për projektbuxhetin e vitit 2020.

Jemi në shqyrtimin në parim të këtij projektbuxheti. Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi dhe në dijeni të kolegëve, por edhe të të pranishmëve, relator do të jetë kolegu Bashkim Fino. Sot do të jetë sërish një ditë e gjatë. Do të kemi 9 institucione sot në komision në dëgjuesën për buxhetin e vitit 2020. Siç u kërkua dje nga disa kolegë, institucioneve që janë në proces dëgjese në Komisionin e Ligjeve, ne u kemi kërkuar që adresimin e nevojave buxhetore për vitin 2020, nëse dëshirojnë, mund ta depozitojnë paraprakisht me shkrim në këtë komision. Sot janë 3 institucione: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Avokati i Popullit dhe Autoriteti për Informimin e Dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, që përveç se do të vijnë të dëgjohen në Komisionin e Ligjeve për projektbuxhetin, i kanë sjellë edhe me shkrim. Unë u kam vënë në dispozicion të relatorit dhe të kolegëve të mi deputetë, të cilëve u kërkoj mirëkuptim për kohën, pasi sot na kanë ardhur. Nëse institucionet që janë në proces dëgjese i kanë me shkrim, në përfundim të asaj që do të shprehin para Komisionit të Ligjeve, mund t'i depozitojnë edhe me shkrim, në mënyrë që relatori, zoti Fino, të ketë një tablo më të qartë të adresimit të nevojave buxhetore për secilin institucion para se të bëjmë raportin për Komisionin përgjegjës të Ekonomisë.

Pa humbur kohë, do të fillojmë me institucionin e Presidencës. Ka konfirmuar pjesëmarrjen zonja Ornela Zonja, sekretare e Përgjithshme e institucionit të Presidentit të Republikës, zoti Petraq Milo, këshilltar i Presidentit të Republikës dhe zoti Arti Çiçolli, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Mirëmenaxhimit Financiar. Kam të konfirmuar edhe zotin Bledar Dervishaj, këshilltar i Presidentit të Republikës, por nuk është paraqitur.

Mirë se keni ardhur sot në komision!

Do t'ju lutesha, për kolegët e mi të komisionit, por edhe për opinionin publik, të flisni shkurt se cilat kanë qenë nevojat buxhetore për institucionin e Presidencës për vitin 2020? Sa vërej këto nevoja janë akomoduar në projektbuxhetin e vitit 2020 nga Ministria e Financave dhe nga qeveria. Çfarë parashtroni sot në Komisionin e Ligjeve për nevojat buxhetore për vitin 2020?

Fjala për ju, zoti Milo.

Petraq Milo – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Financës,

Më lejoni t'ju parashtroj që projektbuxheti për vitin 2020 për institucionin e Presidencës është 252,3 milionë lekë të rinj. Nga këto, personel janë 121,3; operative 121,5 dhe shpenzime kapitale 6 milionë. Më duhet të theksoj se Ministria e Financave ka konsideruar një shtesë prej rreth 3 milionë lekësh të rinj për të përputhur numrin e punonjësve me fondin e pagave, që është plotësuar. Në përgjithësi, ne i kemi të përmbushura nevojat me këtë buxhet që na është miratuar paraprakisht nga Këshilli i Ministrave. Ajo që duam, që praktikisht nuk është plotësuar, sepse ka 2 vjet që kërkohet, është një fond shtesë prej 86,4 milionë lekësh të rinj për të kryer një projekt për menaxhimin në mënyrë dixhitale të të gjithë dokumentacionit të Presidencës, si institucioni më i lartë. Ky projekt do të jetë një investim për të ardhmen, në mënyrë që institucioni i Presidencës t'i ketë dixhitale të gjitha dokumentet. Mendoj dhe gjykoj se ky është një investim shumë i vlefshëm si dhe i domosdoshëm. Ministria e Financave ka limitet e saj, por gjykoj se një miratim dhe implementim i këtij projekti kaq të domosdoshëm në shtrirje në vite, në 2, 3 ose 4, do të ishte i domosdoshëm.

Faleminderit, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Milo!

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Mirëmëngjes!

Faleminderit, profesor dhe ju përfaqësues të Presidencës!

Ju jeni të përkëdhelurit e Ministrisë së Financave. Keni fonde të mjaftueshme për aktivitetin dhe keni rritje në raport me vitin 2019, siç e thatë edhe ju. Unë do ta vazhdoja diskutimin aty ku e latë ju, por edhe më tej. Më shqetëson fakti që këtu shikoj se në 602 milionë për mallra dhe shërbime, ju keni të parashikuar, sipas aktit normativ, 125 milionë lekë dhe brenda 10-mujorit keni realizuar 71,6 milionë lekë. Pra, keni edhe një pjesë tjetër të konsiderueshme për 2 muaj, që është një sasi e madhe, që nuk mund të konsiderohet për dy muaj, nëse do të kemi parasysh edhe qëndrimet politike të Presidentit, që shumë njerëz janë *non grada* dhe nuk mund të vijnë më, do të thotë që do të ketë më pak shpenzime, ndërkohë që këtu keni shumë fonde për t'i shfrytëzuar. Mos duhet ta shikoni më mirë me Ministrinë e Financave? Nuk jam absolutisht për të ulur fondet, sepse aktiviteti i Presidentit duhet të jetë normal, por të shikohet edhe në funksion me institucionet e tjera që do të vijnë më pas.

E dyta, për çështjen e investimeve kam përshtypjen se po t'i shikosh ndër vite, dhe unë e kam që nga viti 2013 evidencën e Presidentit, Ministria e Financave është mjaftuar me

një rritje të vogël të investimeve prej 4,7-4,8-6, duke ngulur te ky nivel, duke i dhënë çdo vit Presidencës një investim prej 6 milionë lekësh.

Zoti Milo, ju si ekonomist më kuptoni mirë me shifrat dhe këtu dua vërtet mendimin tuaj: ju keni 6 milionë investime për vitin 2019. Në 10-mujor keni realizuar vetëm 1,6 milionë. Pra, keni afërsisht edhe 4 milionë të tjerë për 2 muajt që ngelen. Mbase mund të keni bërë dokumente dhe dosje, por janë një sasi e madhe lekësh që nuk janë realizuar dhe është gjynah të digjen fondet, kur mund t'i marrin institucionet e tjera apo mund të bëhen investime të tjera.

Për sa i përket dixhitalizimit, mendoj se do të ishte në nderin e Kuvendit dhe të Ministrisë së Financave që të fillonte ndoshta vitin që vjen. Mesa kuptova unë, profesori nuk tha që ta marrin të gjithë fondin në një vit, por nëse ne fillojmë një program 2-3 vjeçar, të fillojmë me investimin për dixhitalizimin e të gjithë dokumentacionit të Presidencës, si institucion, duke i dhënë një fond të konsiderueshëm prej 10-15 milionësh për vitin që vjen, që të fillojnë, dhe do të ishte shumë e mirë të mbyllej në vitin 2021. Investimet prej 6 milionësh janë rutinë dhe bërja në 10-mujor prej 6 milionësh mua më duket shumë e ulët në raport me atë që ne kemi parashikuar. Jam dakord që në përgjithësi projektbuxheti për Presidencën si institucion është i kënaqshëm për vitin 2020 dhe nuk do të cenojë funksionet e Presidentit dhe të të gjithë trupës së tij. Ishallah kursejnë disa fonde me ato që dëgjojmë, sepse ne na pëlqen kur kursehen fonde, që t'i marrim dhe t'i përdorim për institucionet e tjera që do të kemi në dëgjesa.

Faleminderit, kryetar!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Milo.

Petra Milo – Zoti Fino, po e filloj me investimet.

Kjo është një problematikë. Po të shikoni 8-mujorin e të gjithë buxhetit, investimet janë kryer në masën 40 e ca përqind. Pra, është fenomen i përgjithshëm. Në raportin e Ministrisë së Financave për realizimin e 9-mujorit, investimet janë jashtëzakonisht të ulëta, në një moment kur duhet të kishin shkuar diku te 75%-shi. Gjithsesi, ne kemi investime në proces, të cilat janë gati për marrjen në dorëzim. Mendojmë se do të ezaurohen.

Po kështu, edhe për shpenzimet operative është një efekt sezonal, sepse në 3-mujorin e fundit (nuk dua të ndalem në komentin e zotit deputet), ngarkesa e Presidencës është më e lartë dhe shpenzimet operative janë më të larta. Mendoj se projekti i dixhitalizimit, për të cilin ju falënderoj për mbështetjen, do të ishte shumë pozitiv nëse do të kryhej.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Ministria e Financave.

Sot nga Ministria e Financave, përveç zonjës Vilma Çausholli, na janë bashkuar edhe zonja Mimoza Dhëmbi dhe zoti Fram Brahimaj.

Mimoza Dhëmbi – Zoti kryetar, më falni.

Këtë e kemi zyrtare dhe mund ta merrni.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Sekretaria mund ta marrë dhe ta vërë në dispozicion të kolegëve.

Mimoza Dhëmbi – Ne si Ministri e Financave e vlerësojmë këtë projekt dixhitalizimi, pa dyshim, por mendojmë se nëse studimi dhe projekti janë gati, në ciklin e ardhshëm buxhetor ta përfshijmë të fazuar ...

(Diskutime pa mikrofon)

Ta fillojmë vitin tjetër, sepse është projekt i ri, duhet cikël buxhetor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të bashkojmë edhe 6-n?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

6-n ta bësh 10.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptoj këtë.

Ulsi Manja – Ju lutem, institucioni i Presidencës është dakord dhe i kënaqur me buxhetin Ministria e Financave është e gatshme të akomodojë çdo kërkesë dhe nevojë të Presidencës dhe relatori është dakord.

Ju falënderojmë për prezencën sot në komision, zoti Milo dhe ju urojmë ditë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Parlamenti, normalisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni, ju lutem, sepse e falënderuam zotin Milo dhe stafin e Presidencës për prezencën sot në komision.

(Diskutime pa mikrofon)

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Fakti që ishte prezente sot zonja Ornela Zonja, tregon reflektim, sepse para ligjvënësit ka përherë reflektim.

Institucioni i dytë në radhë është Inspektorati i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Nga Inspektorati kemi prezent në komision zonjën Evgjeni Bashari, sekretare e Përgjithshme dhe zotin Flori Karaj, inspektor pranë këtij institucioni.

Zoti Karaj dhe zonja Bashari, mirë se keni ardhur sot në komision.

Do t'ju lutesha shumë shkurt, nëse keni një material paraprak me shkrim, mund ta depozitoni në përfundim të kësaj dëgjese. Nëse nuk e keni, i ka zoti Fino. Të jeni të sigurt që i ka shumë saktë. Duam të na prezantoni shkurtimisht projektbuxhetin e vitit 2020. A jeni të kënaqur me projektbuxhetin? Cilat kanë qenë nevojat buxhetore? Sa jua ka marrë në konsideratë zonja Dhembli dhe Ministria e Financave këto kërkesa? Çfarë mbështetjeje kërkon sot nga komisioni ynë?

Fjala është për ju.

Flori Karaj – I nderuar, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë!

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, në respektim të dispozitave ligjore dhe rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë për forcimin e mëtejshëm të instrumenteve të hetimit administrativ, të deklarimit të pasurisë dhe parandalimit të zgjidhjes së konfliktit të interesave për personat e zgjedhur dhe nëpunësve publikë në administratën publike ka punuar me kujdes dhe ka ngritur grupe pune për projektbuxhetin që po diskutojmë. Ka pasqyruar të gjitha të dhënat e nevojshme ekonomiko-financiare duke bërë detajimet e duhura analitike për sqarimin e të gjithë elementeve që përbëjnë këtë program në kuadër të nevojave më të domosdoshme institucionale, në përputhje me realizimin e objektivave për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe deklarimin *online* të tyre, kontrollin paraprak aritmetiko-logjik për deklarimin e pasurive dhe konfliktin e interesit për mbi 3 mijë deklarata sipas llojit të subjekteve që bartin detyrime, duke e realizuar këtë detyrim ligjor brenda vitit. Ndërkohë, vite më parë, para vitit 2014, ka pasur probleme.

Është bërë kontroll i plotë për rreth 1600 deklarata pasurie të subjekteve, duke qenë shumë korrekt me skemën e kontrollit të miratuar me ligj. Gjithashtu, është vijuar procesi i kontrollit të plotë të subjektit të rivlerësimit, si dhe kandidatëve për organet e sistemit të drejtësisë.

Ulsi Manja – Zoti Karaj, të lutem fol për buxhetin!

Flori Karaj – Realizimi i prioriteteve të përmendura më sipër bëhet i mundur edhe me mbështetjen dhe miratimin e treguesve të projektbuxhetit për vitin 2020 në shumën 159 500 000 lekë.

Ulsi Manja – Te lekët dil.

Flori Karaj – Paga për punonjësit në shumën 104 860 plotëson të gjitha nevojat për burime njerëzore të këtij institucioni, për 70 punonjës të miratuar nga Kuvendi (nuk kemi asnjë problem, është i përputhur dhe i rakorduar), për sigurimet shoqërore në shumën 15 400 000 lekë jemi dakord dhe nuk kemi ndonjë problem, shpenzimet operative në shumën 36 240 000 lekë janë tepër korrekte dhe me mbështetje të plotë sipas studimeve të bëra nga grupet e punës, si dhe investime në shumën 3 milionë lekë.

Në përfundim, vlerësojmë bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe mbështetjen e vazhdueshme të Komisionit të Ligjeve dhe Komisionit të Ekonomisë për burime njerëzore dhe buxhet të mjaftueshëm financiar për të bërë të mundur realizimin e prioriteteve të përcaktuara për këtë institucion me rëndësi në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik. Pra, ne jemi të kënaqur me këtë projektbuxhet dhe nuk kemi ndonjë problem për ta diskutuar në Komisionin e Ligjeve.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Karaj dhe zonja Bashari!

Flori Karaj – Faleminderit juve!

Ulsi Manja – Është i kënaqur me buxhetin dhe nuk ka asnjë kërkesë, zoti Fino. I mungon vetëm një fletë-falënderimi për Komisionin e Ligjeve dhe për Ministrinë e Financave. Mund të na e kishit sjellë dhe ishim në rregull.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kështu është e vërteta.

Mua gjithmonë më shqetëson fakti, që, ia thashë institucionit të Presidencës, e thashë sot dhe do jua them edhe institucioneve të tjera që vijnë më pas (e kam më shumë me Ministrinë e Financave sesa me institucionet), shpenzimet për mallra dhe investime janë shumë pak të realizuara po t'i krahasosh me ato që kemi dhënë për dhjetëmujorin.

Për sa i përket Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, në qoftë se ne i kemi dhënë në vitin 2019 për mallra dhe shërbime 21,3 milionë lekë, këta kanë realizuar 11,6 milionë. Pra, kanë realizuar gjysmën. Nuk mund të realizojnë gjysmën tjetër për dy muaj, kryetar. Do të thotë që Ministria e Financave i ka parë këta si të nënës, u ka dhënë më shumë dhe vazhdon t'u japë edhe në vitin 2020.

E para, kur ti nuk i realizon dot këto shpenzime, pse duhet të të jap qaq shumë lekë, në një kohë që mund t'ia jap një institucion tjetër që ka mundësi t'i realizojë?

E dyta, në qoftë se vjet parlamenti të ka dhënë 3 milionë lekë investime, deri në fund të tetorit, kur duhen edhe 2 muaj nga mbyllja e vitit, ti ke realizuar vetëm 1,1 milionë lekë. Pra, i bie afërsisht edhe 2 milionë lekë të tjera të parealizuara. Si mund të realizohen 2 milionë për

dy muaj? Ndërkohë, Ministria e Financave i planifikon përsëri 3 milionë të tjera për vitin që vjen.

Nuk ka probleme me shifrat, këta janë të kënaqur, Ministria e Financave po ashtu, por ajo që kërkojmë ne dhe që kërkoj unë personalisht është që të rishikohen shifrat në sensin që ato të shfrytëzohen dhe të jenë efektive për mirëfunksionimin e institucionit për të cilin ju keni ardhur dhe që të mos ju mungojnë fonde nga buxheti i shtetit.

Ju e dini shumë mirë që tepricat që ngelen nuk trashëgohen për vitin 2020, por janë fonde, të cilat, meqenëse ju nuk i përdorët, mund t'i përdorte një institucion tjetër, për shembull një bashki, e cila mund të ketë dhe ka nevoja më të mëdha. Ministria e Financave duhet të na tregojë se si e ka metodologjinë e saj në këtë koncept.

Për shifrat as unë nuk kam asnjë vërejtje dhe mund ta mbyllem këtu, por mos hajdeni përsëri vitin tjetër me mosrealizime në investime apo në zërin “mallra dhe shpenzime”.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja Dhëmbi!

Mimoza Dhëmbi – Dua të bëj një sqarim për buxhetin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurisë.

Ka shpenzime të shtuara në zërin “shpenzime korrente”, shpenzime operative mirëmbajtjeje, nga 21 milionë në 36 milionë. Kjo shtesë vjen për shkak të një sistemi të ri, deklarimi *online*, që ka futur ky institucion dhe për të cilin kërkohet një shpenzim mirëmbajtjeje 10-12 milionë lekë në vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, buxheti është i shtuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është për këtë arsye, po them.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duket sikur nuk është realizuar edhe ky buxhet i ulët dhe ne e kemi rritur. Ideja është që buxheti i rritur i shpenzimeve korrente përmban edhe shpenzimet e mirëmbajtjes të sistemit të ri që sapo kanë implementuar.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Zoti Karaj, nuk besoj se kemi gjë tjetër për të shtuar.

Bashkohem me konstatimet e kolegut Fino. Këto që zoti Fino si relator vuri në dukje për institucionin e ILDKPKI-së të mbahen në konsideratë, sepse vitin tjetër do të jemi përsëri

këtu për të diskutuar projektbuxhetin dhe nuk duam të thoni përsëri që nuk patëm mundësi t'i shfrytëzojmë si duhet të gjitha këto fonde që morëm.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Vazhdojmë dëgjesën me institucionin tjetër në radhë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kemi prezent në komision zotin Ylli Merkaj, sekretar i Përgjithshëm i këtij institucioni dhe zonjën Mirela Gega, drejtoreshë finance.

Zoti Merkaj, zonja Gega, faleminderit për prezencën në Komisionin e Ligjeve! Jemi në këtë dëgjesë për projektbuxhetin e vitit 2020 për institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sigurisht që edhe ju keni adresuar nevojat tuaja buxhetore për vitin 2020 në Ministrinë e Financave. Sa janë marrë në konsideratë nevojat tuaja buxhetore dhe çfarë mbështetjeje kërkon sot në Komisionin e Ligjeve për buxhetin e vitit 2020, në mënyrë që edhe institucioni juaj të kryejë detyrat funksionale që i ngarkon ligji?

Fjala është për ju.

Ylli Merkaj – I nderuar zoti kryetar i Komisionit të Ligjeve!

Të nderuar deputetë anëtarë të Komisionit të Ligjeve!

Duke ju falënderuar dhe vlerësuar ftesën për institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në kuadrin e të gjitha institucioneve të pavarura, për të dëgjuar dhe diskutuar rreth problematikave për projektbuxhetin, shprehemi parimisht dakord për fondet e miratuara për funksionimin e institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Ministria e Financave. Gjithashtu, falenderoj ekspertët e Ministrisë së Financave për bashkëpunimin e vazhdueshëm me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Fondet për funksionin e institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020 janë në të njëjtin nivel me vitin 2019. Në total projektbuxheti i parashikuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është 137 milionë lekë në programin planifikim, menaxhim dhe administrim të nevojshëm për funksionimin e institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Përveç fondeve të parashikuara nga Ministria e Financave, në këtë projektbuxhet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka parashikuar edhe kërkesa shtesë si më poshtë:

Kërkesa e parë është për blerjen e dy automjeteve. Aktualisht institucioni ynë ka në përdorim automjete shumë të vjetra, fugon mallrash dhe fugon pasagjerësh, të prodhimit të vitit 1994. Ky fakt na ka vënë në vështirësi për kryerjen e detyrave institucionale pasi bëhet e pamundur lëvizja e njerëzve dhe e mjeteve në periudhën zgjedhore. Mungesa e automjeteve të transportit e vështirëson së tepërmi mundësinë e inspektimit dhe të transportit të materialeve zgjedhore në të gjithë territorin e vendit. Në përputhje me objektivat dhe detyrat e KQZ-së ky

projekt është shumë i rëndësishëm për arritjen e tyre. Vënia në dispozicion e fondeve për blerjen e një furgoni 8+1 dhe e një furgoni mallrash 2,5 tonë do të na ndihmonte së tepërmi për përmbushjen e detyrimeve tona. Kostoja e parashikuar për këtë investim është 6,175 milionë lekë.

Kërkesa e dytë është për një shtesë kati në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ambiente pune dhe hapësira të përbashkëta. Duke qenë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas vitit 2016 është zhvendosur tek objekti aktual, është e nevojshme të shtohen edhe ambientet e punës për punonjësit pasi edhe numri organik i punonjësve është shtuar në 71 punonjës. Pavarësisht se ne kemi punuar me turne dhe grafikë oraresh të ndryshme, përsëri është e pamundur të punohet në këto ambiente pa kërkuar zgjerim ose shtesë. Duke qenë se një pjesë e godinës së KQZ-së është njëkatëshe, ajo ofron mundësinë për të bërë një shtesë kati prej 250 metra katrorë. Kostoja e këtij investimi është 14,069 milionë lekë. Shuma totale e kërkesave tona buxhetore, përveç kërkesave që ka miratuar ministria e Financave, është 20,244 milionë lekë.

Si përfundim, brenda prioriteteve të projektbuxhetit të vitit 2020, do të vlerësojmë maksimalisht marrjen në konsideratë të kërkesave tona për shtesë fondi të buxhetit të KQZ-së me 20,244 milionë lekë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Merkaj!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Projektbuxheti i KQZ-së është korrekt. Po të shikosh tabelat duket sikur ka mospërputhje, por këto vijnë nga zgjedhjet që në Shqipëri bëhen një herë në 2 vjet. Vetë përfaqësuesi i KQZ-së nuk ka pretendime për projektbuxhetin e paraqitur nga Ministria e Financave.

Për mendimin tim dy pretendimet e tij nuk ekzistojnë. Së pari, ai kërkon blerjen e dy automjeteve, një furgon për mallra dhe një furgon për njerëz. Po të kemi parasysh shpenzimet për mallra dhe shërbime, fondet janë shumë të konsiderueshme dhe asnjëherë nuk janë kursyer fondet për KQZ-në. KQZ-ja mund të marrë furgon me qira për të punuar në ditë të caktuara dhe në kohë të caktuar kur ka zgjedhje. Duhet të jemi koshientë që KQZ-ja ka vërtetë volum të madh pune, por ajo varet në një muaj apo dy muaj në momentin kur zhvillohen zgjedhjet, qofshin të përgjithshme, qofshin lokale. Në këto momente, për shembull, që ne kemi shumë punë apo që KQZ-ja mund të ketë punë me reformën e re zgjedhore, këta janë rehat, në kuptimin që nuk kanë ngarkesën që kanë pasur kur kishin zgjedhjet para 3-4 muajve.

Ne i kemi dhënë KQZ-së një godinë të re, shumë të mirë dhe moderne, kështu që nuk mendoj se ka ardhur koha të shtojmë një kat në atë godinë.

Kam edhe një sugjerim tjetër, kryetar. Unë jam anëtar në Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe ne jemi duke bërë një reformë zgjedhore, e cila mund të ndryshojë edhe strukturën totale të KQZ-së: mund të mos jetë fare kjo që është, mund të mos ketë kaq shumë administratë, e cila është papushim 24 orë gjatë gjithë vitit, në një kohën që sipas reformës zgjedhore po diskutohet të ketë ndryshime strukturore.

Në këtë pikëpamje unë nuk mendoj që Ministria e Financave duhet t'i akordojë këto fonde për vitin që vjen pa mbaruar kjo reformë zgjedhore, edhe sikur të ketë fonde me tepriçë. Unë mendoj që këta duhet të jenë të kënaqur me këtë projektbuxhet që është këtu, pa këto dy kërkesa luksi.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Ministria e Financave...

A kanë pyetje kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është buxheti i shtetit ky. Ne nuk po japim shpërblime për punë të mira, zoti Alimadhi. Ky është projektbuxheti i vitit 2020.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino thotë se i kanë edhe fondet.

Zoti Merkaj, nuk besoj se ka... Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, e thashë edhe në fillim të mbledhjes, i ka sjellë edhe me shkrim disa nga nevojat buxhetore, që i parashtrroi edhe sot para komisionit. Gjithsesi, nuk jemi në një vit zgjedhor. Jemi në proces e sipër edhe të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor. E rëndësishme është që, sido të jetë e ardhmja e këtij institucioni, shteti do të garantojë mbarëvajtjen dhe funksionimin e institucionit në atë format që do të përcaktojë Kodi Zgjedhor dhe ligji.

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

Vazhdojmë me institucionin tjetër në radhë, me Avokatin e Popullit.

Janë prezentë zoti Fatbardh Zenelaj, sekretar i Përgjithshëm, zonja Vilma Shurdha, komisionere e Avokatit të Popullit, si dhe zonja Ermonela Xhafaj, komisionere.

Edhe për institucionin e Avokatit të Popullit në këtë dëgjësë vlen i njëjti përcaktim.

Materiali ka ardhur edhe me shkrim, zoti Fino. Besoj se e keni në dispozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka ardhur sot. Edhe për kolegët deputetë mund të shpërndalet si material.

Zoti Zenelaj, bëni një parashtrim të nevojave buxhetore të institucionit tuaj për vitin 2020, sa janë marrë ato në konsideratë nga Ministria e Financave dhe çfarë suporti apo mbështetje mund të japë Komisioni i Ligjeve për institucionin tuaj.

Fjala është për ju.

Fatbardh Zenelaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Ne e kemi paraqitur materialin me shkrim dhe aty kemi dhënë të gjitha argumentet tona se pse kërkohen fonde buxhetore shtesë. Gjithsesi, shkurtimisht do të thosha se i kemi analizuar të gjithë faktorët për të kuptuar se cilat janë fondet shtesë që kërkojmë në ushtrimin e mandatit tonë, si institucion kombëtar për të drejtat e njeriut.

Së pari, ju e dini që ne jemi institucion me statusin A, që nënkupton se ky institucion duhet të veprojë në përputhje me parimet e Parisit. Këto parime përcaktojnë se ky institucion duhet të ketë një infrastrukturë dhe kapacitete njerëzore financiare të mjaftueshme për të realizuar mandatin e gjerë që gëzon.

Në këtë kuptim, diskutimi i këtij buxheti lidhet edhe me një fakt tjetër shumë të rëndësishëm. Duke filluar nga gushti i 2019-s ne jemi të përfshirë në procesin e riakreditimit, pra rimarrjes së statusit A.

Një pjesë e konsiderueshme e pyetjeve, që lidhen me këtë proces, kanë të bëjë pikërisht me mbështetjen financiare që ofrohet nga buxheti i shtetit dhe me sasinë që ky buxhet arrin të mbulojë nevojat që ka institucioni.

Është e rëndësishme të theksohet fakti që gjatë diskutimit të buxhetit me Ministrinë e Financave ne kemi paraqitur nevojat tona për disa zëra buxhetorë, që mendojmë se nuk janë të mjaftueshëm për realizimin e aktiviteteve. I kemi kërkuar Ministrisë së Financave të rishikojë fondin e pagave, pasi krahasuar me vitin 2019 kemi një ulje të këtij fondi. Pra, në rast se në 2019-n e kemi pasur 90 milionë lekë, në 2020-n ky fond shkon në 86 milionë lekë. Kjo prek pagat e institucionit, sidomos pagat e komisionerëve. Kjo është një çështje që e kemi diskutuar edhe vjet dhe e kemi ezauruar si problematikë.

Së dyti, kemi kërkuar fonde shtesë për zërin nr.602, pra për shpenzimet operative. Ne jemi një institucion që realizon shumë aktivitete, që lidhen me mandatin tonë promovues. Këtu kam parasysh aktivitete të ndryshme, seminare, trajnime, ditë të hapura, si dhe realizimin e studimeve në fusha të caktuara, që sigurisht, kërkojnë edhe fonde shtesë.

E veçanta për vitin në vazhdim ka të bëjë me faktin që institucioni në vitin 2020 ka 20-vjetorin e themelimit të tij dhe është menduar të ketë aktivitete gjatë gjithë vitit, gjë që do të kulmojë me një konferencë ndërkombëtare, që do të realizohet në shtator të 2020-s.

Përveç të tjerave, kjo është arsyeja, të cilën e kemi theksuar edhe në materialin që ju kemi paraqitur, pse është i nevojshëm një fond shtesë për zërin nr.602, pikërisht për të mbuluar aktivitetet që mendojmë të bëjmë në kuadër të 20-vjetorit të themelimit të institucionit.

Kemi kërkuar fonde shtesë edhe për sa i përket zërit nr. 231, pra për shpenzimet për investimet. Këtu dua të ndalem pak, sepse kjo është një çështje që e kemi diskutuar edhe me Ministrinë e Financave. Fondi i investimeve për institucionin ka qenë në shumën 4 milionë lekë për disa vite me radhë. Ky ka qenë trendi. Ka rreth 2 vjet (po flas për buxhetin vitit 2018 dhe buxhetin e vitit 2019) që ky fond është shkurtuar me 50%. Aktualisht, ky fond është 2 milionë lekë të rinj. Në gjykimin tonë, ky shkurtim është i paargumentuar, pasi zëri nr.231 është një ndër zërat që e kemi realizuar në vazhdimësi në masën 97-100% të totalit të tij, aq më tepër që jemi një institucion me 56 punonjës, kemi 6 zyra rajonale në 6 qytete të ndryshme të vendit dhe jemi të akomoduar në një godinë që ka nevojë për rregullime të vazhdueshme.

Kjo është arsyeja pse kemi kërkuar disa fonde shtesë, që lidhen me pajisje zyrash, pajisje kompjuterike, realizimin e një studimi dhe projektimin në lidhje me zyrat e institucionit. Ndërkohë, është përfshirë në këtë projektbuxhet edhe kërkesa për blerjen e një makine, në mënyrë që të kemi mundësinë të realizojmë aktivitetet tona, që lidhen me ditët e hapura, inspektimet, monitorimet e të tjera.

Gjithsesi, nga Ministria e Financave dhe nga komisioni do të kërkonim që, në rastin më të keq, institucionit të paktën t'i ofrohet mbështetja që ka pasur në vitet e kaluara, pra që fondi i investimeve, minimumi, të shkojë nga 2 milionë në 4 milionë lekë, për të mbuluar nevojat që kemi për sa i përket infrastrukturës dhe elementeve që e shoqërojnë.

Kemi pasur edhe kërkesa për rritjen e stafit.

Që të jemi realistë, në të gjitha seksionet e institucionit ka nevojë për mbështetje njerëzore, pasi bëhet fjalë për shumë të drejta që mbulohen dhe për shumë aktivitete që duhet të realizohen. Jemi institucion i vogël. Mandati është shumë i gjerë. Është e pamundur që me këto stafe dhe këto burime që kemi të realizojmë në 100% të mundësive tona mandatin tonë jo vetëm kushtetues, por edhe si institucion kombëtar për të drejtat e njeriut.

Kemi ripërsëritur kërkesën që kemi bërë edhe vjet për krijimin e një nënseksioni për çështjet ligjore, analizë dhe raportim, por këtë herë kemi shtuar edhe nevojën për një ndihmëskomisioner, i cili do të mbulojë çështjet që lidhen me mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

Duke qenë se komuniteti i ministrave të Këshillit të Europës ka miratuar deklaratën përkatëse, njëkohësisht edhe Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar një rezolutë për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, në këtë rezolutë përcaktohet që institucionet kushtetuese

dhe ato të krijuara me ligj duhet të mbështeten qoftë edhe financiarisht për të mundësuar pikërisht mbrojtjen e të drejtave të këtyre individëve.

Këto janë pak a shumë kërkesat tona. Ç'është e vërteta, gjatë diskutimit me Ministrinë e Financave nuk patëm ndonjë dakordësi, por shpresojmë që të paktën këtë herë në Kuvendin e Shqipërisë të ketë një qasje ndryshe, për të mbuluar, në njëfarë mënyre, shpenzimet minimale që duhet të realizojmë në funksion të mandatit tonë.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Zenelaj!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit edhe përfaqësuesit të Avokatit të Popullit!

Buxheti gjithmonë është i pakëndshëm për çdo institucion kur nuk ka mundësi të marrë fondet që ka planifikuar dhe diskutuar. Kjo është normale dhe unë i mirëkuptoj kërkesat tua. Disa prej tyre për mua janë të drejta dhe ne si komision dhe Ministria e Financave duhet të reflektojmë.

Po e nis nga pika e parë. Duhet të kuptojmë që Avokati i Popullit me reformën e re në drejtësi merr pagën e kryetarit të Gjatës së Lartë, pra më shumë se Presidenti i Republikës, që tani nën 12 e ka 257 mijë lekë. E ka përfituar me këtë lloj statusi.

Çfarë ka ndodhur (Jurgis, se ti 1 milion lekë merr)? Ndodh që komisionerët, që miratohen nga ne, marrin 2/3 e pagës së Avokatit të Popullit. Edhe kjo është një shifër shumë e lartë në raport me hierarkinë e pagave në Republikën e Shqipërisë. Këtë e kam trajtuar edhe pardje. Çfarë ndodh më tej? Ne kemi nisur dhe kemi bërë një reformë në drejtësi, si dhe një sërë ligjesh, për t'u dhënë mundësinë financiare komisioneve të vetëqeveritjes që jo vetëm të kenë një pagë, jo vetëm të marrin vështirësi dhe vjetërsinë, por të na e bëjnë këtë reformë për një kohë të caktuar, siç ne e kërkojmë, që edhe ne të jemi në rregull me këtë lloj reforme.

Fakti i përfitimeve të disa institucioneve për shkak të reformës dhe pagave që kanë kryetarët e Gjykatës së Lartë e me radhë, bën të mundur që në ligj të ketë një nen ku thuhet se duhet të trajtohet vështirësia dhe vjetërsia në punë e këtyre punonjësve. Qeveria nuk ka nxjerrë akoma një vendim. Ne e kemi cituar edhe dje. Unë mendoj se duhet të bëjmë një marrëveshje me Ministrinë e Financave, që shumë shpejt, bashkë me Ministrinë e Drejtësisë, të paraqesë një VKM urgjente në funksion të ligjit që kemi miratuar për të vlerësuar se sa do të jetë vjetërsia që do të vlerësohet në përqindje mbi pagën dhe sa do të jetë vështirësia e këtyre sektorëve të tjerë, këshilltarë, komisionerë e kështu me radhë, që do të marrin mbi pagën.

Në këtë moment (ndaj e zgjata pak argumentin tim dhe kërkoj vëmendje nga kolegët) kam përshtypjen se Ministria e Financave nuk ka pasur mundësi ta përlllogarisë dhe të japë një fond page më të lartë (pjesa e sigurimeve shoqërore është në funksion të pagës dhe nuk ka ndonjë problem të madh). Kjo do të thotë se në momentin kur del vendimi i qeverisë, nga ku do të vlerësohet se sa do të jetë vjetërsia në punë si përqindje dhe sa do të jetë vështirësia, automatikisht, Ministria e Financave e ka për detyrë një përlllogaritje të njerëzve që punojnë tek Avokati i Popullit (siç e the ti, 56 veta) dhe me tabelën e re të pagave, t'ju vlerësojë edhe këtë pagë të re. Në momentin kur e vlerëson, automatikisht, do të ketë një shtim të fondit të pagave për institucionin tuaj. Kjo është arsyeja pse ka një diferencë në fondin e pagave, e cila, për mendimin tim, duhet zgjidhur brenda muajit dhjetor, për të pasur mundësinë, edhe nga fondi rezervë që ka qeveria, të zgjidhë problemet jo vetëm me ju (me një pjesë tuajën, jo me pjesën e administratës në tërësi), por edhe me pjesën e tre institucioneve të vetëqeveritjes, që i kisha dje këtu në takimin që bëmë si komision për buxhetin. Kjo ishte e para.

Së dyti, kryetar, jam i mendimit që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse këta nuk duan të dëgjojnë, le të ikin, se vazhdoj vetëm unë...

Ulsi Manja - Ju lutem, kolegë!

Bashkim Fino – Nëse nuk do, ik. Nuk kam asnjë problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam i detyruar të rri, se jam relator, sepse edhe unë do të kisha ikur.

Së dyti, mendoj se Avokatja e Popullit ka të drejtë për investimet. Minimalisht, duhet rritur investimi nga 2 në 4 milionë. Të paktën, investimet duhet të jenë 4 milionë, edhe për shkak të 20-vjetorit vitin që vjen. Realisht, duhet t'i marrim në konsideratë disa gjëra për t'i zgjidhur.

Po ta shohësh, kryetar (këtu kam vërejtje për Ministrinë e Financave, jo për këta), nuk është ashtu siç tha zotëria.

Nuk e di se çfarë detyre keni ju. Sekretar i Përgjithshëm jeni?

Ulsi Manja – Po, sekretar i Përgjithshëm.

Bashkim Fino – Nuk është çdo vit nga 4 milionë, siç thatë ju. Ka pasur edhe më shumë. Në 2014-n ka pasur 15,6 milionë investime; në 2015-n, 17,9 milionë investime; në 2016-n, 25,7 milionë investime; në 2017-n, 12,8 milionë investime; në 2018-n, 3,5 milionë investime, pra një rënie, dhe sot planifikohet 2 milionë. Pra, ka ardhur gjithmonë në ulje.

Moza, unë mendoj se nuk ka arsye të biem në një ulje kaq drastike. Mendoj që 2-milionëshi të bëhet 4 milionë, siç e kërkuan këta.

Nga ana tjetër, për t'u dhënë edhe një ndihmesë tjetër, që të na mirëkuptojnë për pikën e parë, për të cilën fola, të shikojmë mundësinë, të paktën “Mallra dhe shërbime” duhet ta japin në nivelin e aktit normativ nr.2 të vitit 2019. Nëse kanë pasur 16,5 milionë lekë “Mallra dhe shërbime” nuk mund të zbresin te 15 milionëshi, por 1,5 milionë që është po doli ndonjë problem dhe të mbetet në atë nivel 16,5 që ka pasur edhe gjatë këtij viti. Duke e rikapitulluar mendoj se shpenzimet “Mallra dhe shërbime” të shkojnë 16,5, investimet nga 2 milionë të bëhen 4 milionë. Çështjen e pagave do ta shikojmë në kompleksitetin e asaj që thashë më lart dhe nuk dua ta ripërsëris, besoj se mbeten të kënaqur me buxhetin e institucionit të Avokatit të Popullit, pa bërë diskutime të tjera.

Pikën e fundit nuk e trajtova, sepse ne jemi për buxhetin dhe jo për strukturën. Kur të keni ide dhe mendime për strukturën, kur të vini të raportoni trajtojeni edhe problemet e strukturës. Por në lidhje me çështjet që trajtove me 2-3 ndryshimet që thashë dhe një përgjigje që do të marrim për tabelën e pagave, besoj se jeni të kënaqur.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Dhëmbi, me aq sa tha relatori, ne kërkojmë si komision që institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020 t'i akomodohet fondi i nevojshëm për aktivitetet në kuadrin e 20 vjetorit të krijimit të këtij institucioni.

Zëti i investimeve të rritet nga 2 në 4 milionë dhe në mos gaboj shpenzimet “Mallra dhe shërbime” nga 15 milionë në 16,5 milionë.

Të dëgjojmë përfaqësuesen e Ministrisë së Financave.

Mimoza Dhëmbi - Ne e morëm shënim kërkesën dhe do të shikojmë mundësinë për akomodimin e tyre, pasi logjika qëndron.

Ulsi Manja - Zonja Dhëmbi, ne si Komisioni i Ligjeve përpara se të bëjmë raportin për komisionin përgjegjës dhe përpara se të kalojë votimi i buxhetit në parim, më pas nën parim, duhet t'i rakordojmë këto nevoja buxhetore, për të cilat ramë dakord në komision që të gjendet dakordësia edhe në komisionin përgjegjës për t'i akomoduar ato.

Zoti Zenelaj këto janë mundësitë tona, nevojat mund të jenë ato që parashtruat ju, i keni sjellë me shkrim, por unë bashkohem me relatorin dhe mbështes plotësisht sugjerimet e kolegut Fino, që për institucionin tuaj të marrim në konsideratë këto 3 nevoja buxhetore. Dakord? Zonja Xhafaj, zonja Shurdha? Keni pyetje?

Kam një sugjerim, nuk besoj se është nevoja, sepse gjatë këtyre ditëve sekretari i Përgjithshëm, duhet të jetë në kontakt me zonjën Dhëmbi, zonjën Çausholli dhe me relatorin që këto për të cilat ramë dakord këtu, t'i akomodojmë në projektbuxhetin e vitit 2020. Keni

të gjithë kohën e nevojshme në dispozicion që në ditët në vazhdim të shkëmbeni me njëri-tjetrin informacionin që duhet.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

Ulsi Manja - Vazhdojmë me institucionin tjetër me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen: zoti Robert Gajda, Komisioner, zonja Ana Muça, drejtore në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse dhe zoti Erion Lili, specialist i buxhetit në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

Zoti Gajda, mirë se erdhët në komision!

Do t'ju lutem shumë shkurt të bëni një prezantim të nevojave buxhetore të institucionit që drejtoni për vitin 2020. Sa ju ka mbështetur Ministria e Financave, sa e gjeni veten në këtë projektbuxhet? Çfarë suporti mund t'ju japim ne si Komisioni i Ligjeve?

Fjala është për ju.

Robert Gajda- Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje të gjithëve!

Unë nga natyra nuk jam shumë praktik me shifrat, por do të doja të thosha vetëm 3 momente në lidhje me projektbuxhetin që është parashikuar për institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

E para, vëmë re një ulje nga ana e Ministrisë së Financave. Kjo gjë në këndvështrimin tim duhet të jetë një çështje parimore. Unë kam bindjen se për institucionet e pavarura do të duhet që buxheti të mos shkojë asnjëherë në ulje, por të mbetet ai që është ose të ketë tendencë në ngritje.

Shikojmë se për shpenzimet operative ka një ulje, nga 12 milionë e 300 mijë që ka qenë buxheti i vitit 2019, janë propozuar 11 milionë e 300 mijë. Pra, ka një ulje prej 1 milion lekësh të rinj. Ndoshta mund të duken thërrmija për Ministrinë e Financave, por për ne janë të domosdoshme.

Ka edhe një ulje në fondin e pagave që në këndvështrimin tonë nuk e kuptojmë pse dhe duhet ta sqarojmë. Ne kemi pësuar edhe një shtesë në strukturë, të miratuar nga Kuvendi dhe normalisht duhej që fondi i pagave të mos pësonte ulje, sepse nuk e kuptojmë logjikën.

Ndër to shqetësimi më i madh mbetet një situatë që kemi në institucion. Dua t'ua shpjegoj me pak fjalë: i është bërë një kërkesë Ministrisë së Financave që në nxjerrjen e aktit normativ për rikonsiderimin e buxhetit të parashikonte një fond investimi për institucionin e Komisionerit në mënyrë që të garantohet përshtatshmëria e institucionit për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Kjo lidhet pak edhe me natyrën e veçantë si institucion,

sepse jemi në mbrojtje të personave me aftësi të kufizuara, prandaj natyrshëm duhet që ne të parët, para se të monitorojmë të tjerët të garantojmë aksesueshmërinë. Me shumë mirësjellje kjo është aprovuar nga ana e Ministrisë së Financave, por problemi që ka lindur është se akti normativ këtë herë ka dalë shumë vonë, çelja e fondit nga ana e Ministrisë së Financave është bërë akoma më vonë. Ne aktualisht jemi në situatë prokurimi, por rrezikojmë që për shkaqe të ndryshme që kanë prokurimet, ky prokurim të na dështojë. Urojmë që jo, sepse kohët janë strikte, por ne jemi në këtë fazë. Ajo që kërkojmë është se ky fond investimi shtesë që na është dhënë nga Ministria e Financave nëpërmjet aktit normativ të parashikohej për vitin 2020. Në eventualitetin që prokurimi shkon mirë për këtë vit, ai fond më pas të riallokohej pa pasur asnjë lloj kërkesë nga ana jonë për Ministrinë e Financave në momentin që duhet të riallokohet.

Tri janë momentet që na shqetësojnë.

E para, ulja e shpenzimeve operative me një milion lekë. Do të donim të qëndrojmë aty ku është. Nuk kemi pretendime, por të paktën të qëndrojmë aty ku ishim.

Në lidhje me fondin e pagave, ka pasur pakësim nga ana e Ministrisë së Financave. Të na jepet garanci që të paktën për projektbuxhetin e vitit 2020 të parashikohet fondi i investimeve me atë kërkesë që kemi bërë dhe nëse prokurimi shkon mirë këtë vit, do të jemi shumë të lumtur. Të riallokohet fondi, nëse nuk shkon mirë, të kemi mundësi të përdorim fondin për të bërë përshtatshmërinë e institucionit për personat me aftësi të kufizuara.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Gajda!

Zoti Fino.

Bashkim Fino - Falënderoj Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi!

Unë nuk do të bëj debat me ju. Cili është drejtori i Financave që të më kuptojë më mirë? Ju jeni? Atëherë, dëgjoni! Ju në projektbuxhetin e vitit 2019 keni 57,3 milionë lekë, totali i shpenzimeve 9 milionë lekë. Sivjet qeveria ju propozon që t'ju japë 52,7 milionë lekë, pra një ulje. Këtë që e tha edhe Komisioneri, me të drejtë.

Tani i marrim dhe i analizojmë gjërat një nga një, sepse ne të dy jemi ekonomistë. Vijnë te pagat, që janë kryesore. Nuk ka të drejtë Ministria e Financave, ta them hapur dhe botërisht që 34 punonjës të Komisionerit që kemi miratuar në parlament të mos marrin pagat dhe sigurimet shoqërore për të gjithë vitin. Absolutisht, kjo nuk ndodh në asnjë buxhet dhe me asnjë institucion. Kjo është e vërteta.

Vijnë te çështja e mallrave dhe shpenzimeve. Në vitin 2019 ju keni planifikuar, ne ju kemi dhënë si parlament 11, 1 milionë lekë të 602-shi. Ju keni realizuar deri në fund të muajit tetor 6,4 milionë lekë, pra keni afërsisht edhe 5 milionë për të harxhuar.

Pyetja ime: a mund t'i harxhoni dot 5 milionë të rinj për 2 muaj? Jo, sepse ke harxhuar 6,4 për 10 muaj, si do t'i harxhoni 5 milionë për 2 muaj? Është një shifër shumë e madhe. 6,5 dhe 5 bëjnë 11. Ministria e Financave, kam vërejtje për këtë të fundit përsëri të ka planifikuar për vitin 2020 11,1 milionë lekë. Nuk ta ka rritur, ndoshta duhet të rriste diçka. Jam dakord me komentin e Komisionerit, se gjithmonë ka rritje në buxhet për "Mallra dhe shërbime". Nuk mund ta linte fiks 11,1, por mund ta bënte edhe 12. Unë propozoj që ta bëjë 12, sepse nuk ka asgjë të keqe. Vërejtja që kam për ju si financiare është se duhet t'i realizoni këto shpenzime, sepse nëse ti nuk i realizon, atëherë pse të t'i jap? Mund t'ia jap një institucioni tjetër. Më kuptuat?

Vijmë te pika e tretë, investimet. Po marr në konsideratë argumentimin që dha komisioneri. Keni pasur 5 milionë lekë investime në vitin 2019, keni realizuar 0,6, por ndoshta do të jetë ajo që tha komisioneri dhe e besoj atë që është në proces tenderimi aksesueshmëria e njerëzve në nevojë, që e keni bërë si tender. Nëse kjo realizohet, me siguri do të shkojë te 5 milionëshi, duke realizuar investimet.

Zoti Komisioner, ai investim duhet të mbarojë sivjet.

E para, është mirë për ju për ta bërë këtë vit.

E dyta, që të fitoni një investim tjetër për vitin 2020 rreth 1 milionë lekë. Nuk ka mundësi asnjëherë që të rrimë dhe të presim nëse mbaroi apo jo tenderi juaj dhe nëse nuk mbaroi ai, ne ta planifikojmë për investim për vitin që vjen. Nuk ka se si të bëhet kështu. Ai duhet të bëhet patjetër, duhet të krijoni të gjitha hapësirat teknike dhe ligjore që të realizohet sivjet dhe ta keni këtë investim, ta keni edhe 1 milionëshin për vitin tjetër, sepse në të kundërt nuk mundet dot të themi: "Të presin njëherë bëhet apo jo". Në momentin që ti na njofton se nuk u bë ky tender, ka kaluar buxheti në parlament. Si do t'ia bëjmë? Nuk ecim dot me këtë logjikë. Unë mendoj se ju duhet të interesoheni që ta mbyllni, se fondet i keni për këtë investim me argumentin që thatë. Këto investimet e tjera për vitin tjetër janë pasi keni gjëra të tjera për të marrë si: karrige, kompjuterë e të tjera gjëra që ju interesojnë.

Për të dy pikat e para unë mendoj se duhet të ketë një rakordim më specifik, teknik. Komisioni me këtë vendin duhet të dalë që pagat dhe sigurimet shoqërore do të jenë të garantuara për 34 punonjësit që ka komisioneri për vitin 2020 me shifrat që do të jenë të sakta dhe të rakorduara nga ana juaj, si dhe me kushtin e dytë që "Mallrat dhe shërbimet" të jenë 12 milionë lekë, rreth 1 milion më tepër, në krahasim me vitin 2019 që të jemi korrektë, por me merakun që ju duhet ta mbyllni këtë vit atë investim, pasi nuk mund t'i themi Drejtorisë së Buxhetit: "Komisioneri nuk e mbyll dot këtë investim, prandaj hajde që t'i planifikojmë 5 milionë për vitin tjetër!". Është e pamundur nga pikëpamja financiare. Po të flas si financier

tani. E kuptoj shqetësim tënd, të mirëkuptoj jashtëzakonisht shumë, por edhe të planifikoj investim më shumë me idenë se mund të mos bëhet, këtë gjë nuk e bëj dot. Ja u bë investimi, atëherë çfarë do të bëni me investimin tjetër? Më kuptoni! Ju fola në mënyrë shumë të sinqertë dhe me dashamirësinë që ka grupi andej për ju si Komisioner.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Fino!

Po, zoti Gajda,

Robert Gajda - Mua më shqetëson vetëm një moment, sepse institucioni rrezikohet të ngel papërshtatshëm. Procedurat nga ana e institucionit jemi munduar t'i bëjmë, por gjëja që më ka shqetësuar më shumë ka qenë koha. Pra, gjërat jemi munduar t'i bëjmë ashtu siç duhet, por rrezikojmë shumë, edhe për shkak të ankimeve apo çfarëdolloj gjëje që ne të na dështojë gjëja.

(Zoti Fino flet pa mikrofon)

Dakord.

(Zoti Fino flet pa mikrofon)

Bashkim Fino – Ju thoni: Nëse bëhet investimi, më jepni 5 milionë, por nëse nuk bëhet, unë nuk e dua, por më jepni investimin që planifikuat. Po si ta shkruaj këtë, nuk e shkruaj dot, sepse më 5 dhjetor ky buxhet kalon në parlament në parim. Po, kishte një rrugë tjetër. Cila ishte rruga? Rruga ishte që ti ta bëje, por nuk e bëre. Vitin tjetër eja që të interesohemi dhe me këtë 1 milion që ke, të shtojmë nga fondi rezervë edhe 2-3 milionë të tjera që ta bëjmë atë. Por përsëri të them, duhet të interesohesh që ta bësh, sepse është më me interes ta bësh me të gjithë kapacitetet që ke, mos u merr shumë me mbrojtjen nga diskriminimi, por merr më shumë me këtë investim dhe zgjidhet kjo punë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

A bie dakord Ministria e Financave për të akomoduar dhe për të rakorduar ato që tha zoti Fino, për fondin e pagave dhe sigurimeve për 34 punonjës, sipas strukturës që kemi miratuar?

Mimoza Dhëmbi – Po.

Ulsi Manja – Edhe zërin e investimeve nga 11,3 për ta shtuar pak, siç tha edhe zoti Fino.

Mimoza Dhëmbi – Unë ju garantoj fondin e pagave, padiskutim. Të vijë specialistja dhe ta rakordojmë. Ne kemi një databazë për të gjithë shtetin shqiptar, prandaj të shikojmë se kush ka të drejtë ne apo këta, për 0,6 milionë që bëhet fjalë, nuk është asgjë për ne.

Ulsi Manja – Dakord. Zoti Gajda, drejtoresha e financave dhe investimeve të rakordojë me zonjën Dhëmbi gjatë këtyre ditëve, por ne duhet ta kemi të saktësuar këtë përpara kalimit të projektbuxhetit.

Ne kemi të gjithë vëmendjen e duhur dhe dashamirësinë që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi t'i ushtrojë si duhet funksionet që i ka ngarkuar Kushtetuta dhe ligji. Në vlerësimin tim, ky institucion, më në fund, e ka gjetur veten edhe nuk besoj se ky institucion ka çaluar te mbështetja buxhetore që ka pasur ndër vite, por kanë qenë probleme të tjera, të cilat ne i kemi trajtuar kur ju keni raportuar për veprimtarinë e institucionit që drejtoni. Gjithsesi, jo vetëm për institucionin tuaj, por për të gjitha institucionet që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, Komisioni i Ligjeve është treguar i vëmendshëm.

Pak më parë ishte Avokati i Popullit, tani jeni ju dhe në radhë janë kolegë të tjerë të institucioneve që monitorojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ne kemi dashamirësinë t'ju mbështesim. Ne do të bëjmë avokatinë edhe te Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, që është komision përgjegjës dhe në seancë plenare. Pra, nuk mjafton vetëm dëshira jonë, por duhet edhe mbështetja e Komisionit të Ekonomisë, sepse ka edhe shumë agjenci të tjera që kanë nevoja buxhetore njëlloj si ju.

Zoti Gajda, faleminderit dhe ditë të mbarë!

Vazhdojmë me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Prezent kemi zotin Besnik Dervishi, Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Zoti Dervishi mirëserdhët në komision!

Zoti Fino, nga eksperiencia e mëparshme zoti Dervishi nuk del nga komisioni pa marrë diçka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj jam i bindur që edhe këtë vit ka ardhur me një bllok kërkesash.

Përpara se të fillojmë me prezantimin e nevojave buxhetore, unë dua të falënderoj, zotin Dervishi, për organizimin e shkëlqyer të konferencës ndërkombëtare që ishte para pak kohësh në Tiranë, këtë e bëj edhe në emër të kolegëve të mi deputetë të Komisionit të Ligjeve. Pra, pse jo, Ministria e Financave, qeveria dhe Kuvendi duhet t'i trajtojnë këto institucione si duhet, kur në ushtrimin e veprimtarisë së tyre apo në ushtrimin e detyrave që u ngarkon Kushtetuta dhe ligji nderojnë veten si institucion, por edhe shtetin shqiptar.

Zoti Dervishi, i njëjti rregull vlen edhe për ju, çfarë nevojash keni parashtruar për vitin 2020, sa janë marrë në konsideratë nga Ministria e Financave dhe çfarë mund të suportojmë ne si Komisioni i Ligjeve?

Fjala është për ju.

Besnik Dervishi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam mirënjohës për kontributin që keni dhënë për zyrën e Komisionerit, jo vetëm ju si Komision i Ligjeve, por i gjithë Kuvendi, sepse zyra e Komisionerit nuk do të ishte në këto nivele pa mbështetjen dhe kontributin tuaj.

Ne këtë vit organizuam një aktivitet shumë të rëndësishëm, i cili nuk mund të organizohej pa mbështetjen tuaj dhe të shumë institucioneve të tjera të qeverisë shqiptare, si: Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, rezultatet e të cilit nuk do të jenë vetëm për këtë vit, por do të jenë edhe për vitet në vijim. Prandaj ne duhet ta mbajmë lart këtë standard.

Në këtë komision institucionet prezantojnë problematikat e tyre në lidhje me buxhetin, por unë mendoj se duhen thënë edhe disa gjëra pozitive. Në këtë këndvështrim buxheti i zyrës së Komisionerit, po të shikohet në vijimësi, pra në vite, shikohet që sot kemi një institucion që nuk ka nevoja emergjente, sepse investimet janë realizuar 100%. Ne sot kemi mjedise pune jo në kuptimin formal, por edhe sisteme të teknologjisë që u përgjigjen kërkesave të kohës dhe standardeve të Bashkimit Europian dhe besoj se duhet përmendur dhe vlerësuar.

Për sa i përket buxhetit të këtij viti, për atë që është llogaritur nuk kemi problem me fondin e pagave dhe sigurimet shoqërore. Ka një ulje të shpenzimeve operative, por mbase edhe kjo nuk do të ishte shqetësuese, sepse ne operojmë me shumë projekte dhe çdo vit ne i kemi plotësuar nevojat me projekte, pavarësisht se shpenzimet operative nga viti në vit kanë qenë të pamjaftueshme. Shpresojmë që edhe këtë vit ato projekte që kemi parashikuar t'i realizojmë dhe mendojmë që nuk do të kemi probleme.

Për sa u përket investimeve, investimet e vitit të kaluar janë realizuar 100% dhe e kanë sjellë zyrën e Komisionerit në këto standarde që kemi sot. Duhet theksuar që investimet që i janë akorduar zyrës së Komisionerit, për disa prej tyre përfituese, nuk është vetëm zyra e Komisionerit, por janë edhe dy institucione të tjera, si Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil dhe Avokatura e Shtetit, sepse jemi në të njëjtën godinë dhe disa investime kanë qenë të përbashkëta.

I vetmi problem që mbetet i pazgjidhur për zyrën e Komisionerit, për të cilën ndoshta jam bërë i mërzitshëm duke e përsëritur nga viti në vit, lidhet me plotësimin e strukturës së zyrës së Komisionerit. Sinqerisht do të doja t'i jepej fund këtij problemi, sepse që në vitin e parë që jam emëruar nga ana juaj në këtë detyrë, por edhe me rinovimin e mandatit të dytë, për këtë gjej rastin t'ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen, mbetet e paplotësuar struktura e të drejtës për informimin. Kjo është një detyrë e re që i është shtuar zyrës së Komisionerit që në

vitin 2014 nga ekspertët e huaj, nga ata që kanë ndërtuar edhe planveprimin afatmesëm dhe afatgjatë të funksionimit të strukturës për të drejtën e informimit. Pra, kur ne kishim një nivel prej 200 ankesash në vit, është propozuar një strukturë me 10 persona. Vetëm vitin e kaluar janë trajtuar 820 ankesa përveç detyrave të tjerave që parashikohen, si monitorimi i programeve të transparencës e të tjera me radhë. Pra, ne nuk kërkojmë më shumë se sa janë planifikuar, pra 10 persona. Në vitin 2018 është bërë një mbështetje e pjesshme me një shtesë prej 2 personash, por nevojitet të plotësohet kjo strukturë.

Për sa i përket anës tjetër, mbrojtjes së të dhënave personale, unë e kam thënë që prej 3 vjetësh jemi anëtarë të Bordit European të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, pra Komisioneri shqiptar ulet në të njëjtën tryezë me komisionerët e Mbrojtjes së të Dhënave të vendeve anëtare të Bashkimit European. Pra ky është një sukses jo i vogël për vendin tonë, por ne duhet ta mbajmë këtë pozicion.

Rregullorja e re e përgjithshme e Bashkimit European në dallim me aktin e vjetër që rregullonte marrëdhëniet e mbrojtjes së të dhënave në Bashkimin European, me direktivën nr. 9546 përcakton disa standarde të reja, ku më kryesorja është përshtatja e sistemeve të mbrojtjes së të dhënave personale me teknologjinë e informacionit. Pra me atë që sot është problem dhe që dëgjohet dita-ditës në të gjitha debatet dhe problematikat që ngrihen në zhvillimin e teknologjisë. Kjo është detyrë që neve na buron nga rregullorja për ngritjen e strukturës së monitorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit pranë zyrës së Komisionerit dhe monitorimin e ndjekjen e çështjes së mbrojtjes së të dhënave personale në organet ligjzbatuese.

Pa u zgjatur shumë do t'ju përmend një tjetër sukses të qeverisë shqiptare, hyrja në fuqi e marrëveshjes me Euro Just-in. Për këtë ne kemi pasur një plan veprimi të përbashkët me Prokurorin e Përgjithshëm, ku zyra e Komisionerit për 5 muaj ka qenë 100% e angazhuar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në prokuroritë e rretheve për ta sjellë prokurorinë shqiptare në standarde që kërkon Euro Just-i. Për inspektim ka ardhur oficeri i Mbrojtjes së të Dhënave të Euro Just-it, i cili ka kryesuar misionin dhe ka vlerësuar shumë pozitivisht. Pra falë këtij raporti është bërë efektive edhe marrëveshja.

Në marrëveshjen e ratifikuar me ligj nga parlamenti i Shqipërisë parashikohet që oficeri i Mbrojtjes së të Dhënave të Euro Just-it dhe Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave përgatisin çdo vit raportin e auditimit të prokurorisë shqiptare dhe të Ministrisë së Drejtësisë për t'ia dorëzuar Bashkimit European. Natyrisht për një strukturë tejet e nevojshme kërkohen burime njerëzore për të realizuar këto detyra shumë të rëndësishme, të cilat janë të lidhura fort me integrimin european.

Konkretisht që në vitin 2016 kemi kërkuar që struktura e Komsionerit të jetë me 46 vetë, e kemi përsëritur në vitet 2017, 2018 dhe në 2019. Këtë vit besoj se janë të gjitha argumentet e nevojshme që të mbyllim një standard dhe që zyra e Komsionerit të funksionojë në normalitet.

Faleminderit për vëmendjen!

Ulsi Maja – Faleminderit, zoti Dervishi!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Zoti Dervishi nuk ka vërejtje për projektbuxhetin, pavarësisht se ka një ndryshim dhe duket sikur në vitin 2019 ka marrë në total 84,7 milionë shpenzime dhe planifikimi është 69,6, por duhet të keni parasysh që në shumën prej 84,7 milionësh bëjnë pjesë 16 milionë të investimit që ka pasur këtë vit. Pagat, sigurimet shoqërore dhe mallrat e shërbimet janë njëlloj, nuk kanë ulje. Pra, edhe për atë që tha se ka ulje me 602, jo e ke 17,8 milionë, pra e ke njësoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, tani po flas me shifra. E ke këtë shifër, apo nuk e ke? Është njëlloj si viti 2019. Pra këtë vit kishe edhe konferencën dhe përsëri e ke njësoj. Për vitin 2020 ke 17,8 milionë lekë më shumë se të gjithë komisionerët e tjerë. E vetmja ulje është tek investimet dhe kjo me të drejtë, sepse nuk mund të ketë investime gjithmonë, por as ju nuk e kërkuat.

Ju thatë se i keni realizuar investimet, ndërsa në listën që kam këtu nuk më rezulton, as nga thesari dhe as nga ministria, vetëm nëse i realizoni gjatë muajit nëntor. Pra nga 16 milionë investime, ke realizuar 0,3 milionë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, dua të them që duhet t'i realizosh, sepse ti e di që digjen dhe nuk trashëgohen.

Tani kalojmë te struktura, të cilën e kërkojnë të gjithë. Edhe KLP-ja e kërkoi dje, pavarësisht se i kemi bërë dy herë ndryshim strukturës së KLP-së, ashtu siç e ka kërkuar. Por këta nuk kuptojnë një gjë. Çfarë nuk kuptojnë? Këtu ju vini për projektbuxhetin, jo për strukturën, sepse struktura është koncept tjetër dhe keni gjithë vitin në dispozicion. Në parlament vjen dy herë për të raportuar dhe, kur raporton për performancën e punës, ke mundësi të shprehesh sugjerime për strukturën.

Zoti Dervishi, ju thoni që keni kërkuar që nga viti 2014 plotësimin e strukturës për të drejtën për informim. Po të doni mund ta shikojmë ecurinë e numrit të punonjësve të institucionit tuaj. Në vitin 2013 kanë qenë 29 veta, në vitin 2014 kanë qenë 27 veta, në vitin 2015 kanë qenë 31 veta, në vitin 2016 kanë qenë 35 veta, në vitin 2017 kanë qenë 35 veta, në vitin 2018 kanë qenë 37 veta dhe në vitin 2019 janë 37 veta. Edhe komisionerët e tjerë në

Republikën e Shqipërisë kanë po kaq, madje kanë më pak, për shembull, Komisioneri për Shërbimin Civil ka 31 veta, Komisioneri që sapo iku ka 34 veta dhe ju si më i privileguari i komisionit tonë keni 37 veta. Pra, komisionerët në tërësi kanë nga 31 deri në 40 veta në numrin e punonjësve.

Në vitin 2018 ke kërkuar 10 dhe ke marrë 2, unë mendoj që nuk do të ishte mëkat të shtonim edhe 3, nëse Ministria e Financave bie dakord, edhe pse ne nuk po diskutojmë strukturën tënde, por po diskutojmë projektbuxhetin e vitit 2020.

Zoti kryetar, me shifrat që janë këtu jemi në rregull, por, nëse Ministria e Financave e ka mundësinë për të shtuar edhe këta të tre, ne e mbyllim përfundimisht që të mos kemi asnjë shtesë tjetër. Të gjitha institucionet i kemi fryrë aq shumë dhe vazhdojmë t'i fryjmë më shumë seç duhet, pastaj kur ne i kemi mbaruar punët, ata vijnë dhe kërkojnë edhe gjëra të tjera, a thua se ne nuk e kemi diskutuar më përpara këtë çështje dhe gjithmonë vijnë dhe kërkojnë, e kërkojnë. Ky është interpretimi që kam unë për këtë punë.

Ulsi Manja – Ç'mendim ka Ministria e Financave?

Mimoza Dhëmbi – Ne bashkohemi me analizën dhe logjikën e zotit Fino. Nëse ju e mbështesni shtesën e personelit, sepse është kompetenca juaj, ne mund ta marrim si detyrë.

Ulsi Manja – Zoti Devishi, edhe një koment të fundit.

Besnik Dervishi – Unë ju falënderoj ju dhe veçanërisht zotin Fino për saktësinë dhe korrektesën e shifrave. Është në interes të këtij komisioni për të ditur që një investim nuk e kemi shlyer akoma, por nuk lidhet me ne, sepse ne i kemi mbaruar të gjitha procedurat, por lidhet me një vepër publike që po zhvillohet afër dhe po bën disa ndërhyrje infrastrukturore që lidhen indirekt me ne. Me përfundimin e punimeve nga subjekti tjetër, subjekti që ka fituar tenderin do të bëjë punimet dhe kjo është e mbyllur brenda këtij viti dhe nuk diskutohet.

Për sa i përket numrit të punonjësve, ne e kërkojmë me buxhetin, sepse në një nga tabelat e buxhetit përcaktohet edhe numri i përgjithshëm i institucioneve buxhetore dhe nëse ne nuk do të kishim numrin e miratuar në buxhet, natyrisht nuk do të kishim mundësi edhe për përmirësimet në strukturën dhe organikën e institucionit.

Unë e kuptoj që analiza është shumë e drejtë, por duhet të më kuptoni edhe mua në këtë pikë. Ne jemi një institucion që modestisht përpiqemi të punojmë me vlerësimin maksimal për institucionet e tjera të pavarura, por, po të shikoni fushën e veprimtarisë së zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, ka një gamë shumë të gjerë veprimtarish. Pra, janë gati 10 ligje që caktojnë detyra të veçanta dhe vetëm vitin e kaluar janë shtuar dy detyra të tjera që unë i përmenda. Në të njëjtën kohë në parlament është në proces diskutimi edhe i një ligji tjetër, për një shtesë në ligjin e Policisë Kufitare, ku

futet një sistem i ri për PNR-të, për rekordet e emrave të pasagjerëve, dhe Komisioneri duhet të auditojë Policinë e Shtetit dhe të përgatisë raportin për Komisionin European një herë në dy vjet. Pra janë disa detyra funksionale, të cilat i besohen zyrës së Komisionerit, lidhen me një prioritet absolut që është integrimi i vendit dhe do të bëhen. Por e mira është që këta njerëz të merren që sot e të trajnohen dhe të jenë ekspertë në standardet që kërkon Bashkimi European. Kjo është kërkesa dhe ky duhet të jetë kuptimi dhe mirëkuptimi për numrin e punonjësve që unë kërkoj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Dervishi!

Zoti Fino, Komisioneri thotë: “Më jepni lekët, tani se ndryshimin e strukturës do ta sjellë pak më vonë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për numrin e punonjësve po flas.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, përfundimisht lidhur me kërkesën e Komisionerit për shtim të numrit të punonjësve, ne jemi me variantin që numri i punonjësve me këtë projektbuxhet është 82377 dhe të ngelet po ky.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal 82337.

Besnik Dervishi – Ka një rezervë punonjësish, ku unë mendoj se mund të mbështetet zyra e Komisionerit.

Ulsi Manja – Fjalën e ka zoti Fino.

Bashkim Fino – Rezerva është për institucionet e qeverisjes qendrore, për institucione që krijohen të reja dhe ka rreth 100 vende, por institucioni juaj nuk është i ri, sepse ka disa vite që është krijuar. Unë si relator i propozoj Ministrisë së Financave, dhe ajo pranoi, pra është e gatshme, që ne do të shohim këtë, që dy i keni marrë. Më pas të merrni edhe tre, që të bëheni dyzet..., por është jashtëzakonisht shumë i madh numri i punonjësve që ju keni në institucionin tuaj. Unë propozoj që të shtohen tre vetë.

Ulsi Manja – Atëherë, propozimi i kolegut Fino është që të kemi edhe tre vetë shtesë në strukturë, që të shkojë numri dyzet. Gjatë këtyre ditëve zonja Dhëmbi, mund të rakordoni me zyrën e Komisionerit. Parimisht, si komision, ne jemi dakord që të shtohet me tre vetë numri i punonjësve. Po rakorduat dhe gjenden fondet e nevojshme për pagat, plus sigurimet shoqërore, pse jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zoti Dervishi! Ngado që ta vërtitim, ti kërkon të shtosh tre-katër punonjës në strukturë. Kjo është e gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Dervishi, shumë faleminderit për prezencën tuaj në komision!

Zoti Fino, besoj se s'kemi çfarë të shtojmë më në lidhje me buxhetin e Komisionerit.

Shumë faleminderit për prezencën!

Besnik Dervishi – Faleminderit juve!

Ulsi Manja – Vazhdojmë me institucionin tjetër në radhë. Është Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, ju lutem, ngatërresë e imja. Ju kërkoj ndjesë zonja Sula!

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Kemi këtu zonjën Pranvera Strakosha, komisionere, dhe zonjën Ollga Hodaj, drejtore e Financave dhe e Shërbimeve Mbështetëse.

Zonja Strakosha, urime për mandatin tuaj të dytë në krye të këtij institucioni! Mirë se keni ardhur sot në komision!

Do t'ju lutesha që, shumë shkurtimisht, të na flisnit në lidhje me nevojat buxhetore që keni parashtruar për vitin 2020 për Ministrinë e Financave, sa ju janë marrë në konsideratë dhe çfarë mbështetje kërkonin nga komisioni. I duam në terma analitikë, shkurt, sepse zoti Fino e ka të qartë tabelën e buxhetit të institucionit tuaj më mirë nga sa mund ta ketë Ministria e Financave dhe ju.

Fjala është për ju!

Pranvera Strakosha – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju falënderoj për mbështetjen në lidhje me rizgjedhjen time në këtë institucion.

Shkurtimisht, do të them vetëm dy fjali: për vitin 2019 kemi realizuar buxhetin në masën 89 %, dhe sipas parashikimeve, deri në fund të vitit do të shkojmë drejt 100 përqindëshit.

Për vitin 2020 nuk kam asnjë objeksion apo kërkesë në lidhje me buxhetin.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zonja Strakosha!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Unë e falënderoj zonjën Strakosha, sepse sot ka ardhur në komision për të respektuar komisionin, sepse institucionet që i konsiderojnë të akomoduara nevojat buxhetore për vitin 2020 mund ta njoftojnë Kuvendin edhe nëpërmjet një shkrese, që janë të kënaqur me buxhetin,

dhe të mos vijnë fare. Prandaj, unë e falënderoj që ka ardhur sot, që ka respektuar komisionin. Nuk është absolutisht çudi. Si duket, ka pasur një rakordim të mirë me Ministrinë e Financave, dhe është e kënaqur me projektbuxhetin e vitit 2020.

Zoti Fino, jemi dakord.

Zonja Dhëmbi, shumë të lumtur.

Zonja Strakosha, shumë faleminderit, dhe fillim të mbarë për mandatin e dytë, siç thotë kolegja Xhina! Punë të mbarë në krye të institucionit!

Kalojmë në institucionin tjetër, që është në radhë: Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Kemi të pranishëm në komision zonjën Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit, zotin Simon Mirakaj, anëtar, zotin Marenglen Kasmi, anëtar, zotin Altin Hoxha, anëtar, zotin Skënder Vrioni, Sekretar i Përgjithshëm, zonjën Vitori Fuqi, përgjegjëse e Financës, zonjën Mirela Lame, përgjegjëse e sektorit juridik dhe prokurimeve.

Nuk e di nëse harrova ndokënd, zonja Sula, nga që keni ardhur i gjithë institucioni, dhe mirë keni bërë, sepse çështjet e buxhetit duhet të jenë çështje transparente deri në fund.

Sigurisht, zonja Sula ka sjellë edhe një material me shkrim në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2020, për Komisionin e Ligjeve. Unë ua kam vënë përpara kolegëve të mi deputetë, po për të qenë efikasë edhe me kohën, zonja Sula, do t'ju lutesha të shpreheshit qartë dhe saktë në lidhje me nevojat buxhetore që keni parashtruar për vitin 2020 në Ministrinë e Financave, sa janë akomoduar dhe çfarë mund të bëjmë ne për institucionin që ju drejtoni, gjithnjë duke ju falënderuar si drejtuese e institucionit, bashku edhe me kolegët tuaj, sa u takon përpjekjeve që keni bërë për të pasur më në fund edhe ju, si institucion, një godinë dinjitoze, të cilën në vlerësimin tim e meritoni. Ai institucion meriton gjithë mbështetjen e këtij komisioni dhe të Kuvendit të Shqipërisë.

Fjala është për ju!

Gentiana Sula – Përshëndetje të gjithëve!

Ju falënderoj që na dhatë mundësinë të shprehemi në lidhje me nevojat për buxhetin e vitit 2020, por edhe në lidhje me PBA-në, për të cilën gjithashtu kemi komente.

Së pari, në parantezë, ne vijmë këtu pas raportimit që kemi bërë në prill. Besoj se raporti ynë flet vetë, ndaj nuk do të doja të ndalesha në ecurinë dhe arritjet që kemi. Gjithsesi, më duhet të them se institucioni po përballlet me një shtesë në numrin e kërkesave, qoftë individuale, institucionale, të kërkimit shkencor dhe aktiviteteve, që ne e vlerësojmë në rreth 30 %. Këtu shtohet edhe tendenca në rritje, sidomos nga vetingu i policisë, që tashmë merr goxha nga volumi ynë, sepse, siç jeni në dijeni, ligji “Për verifikimin e figurave në Policinë e

Shtetit” na kërkon angazhim dhe verifikim të të gjithë personelit, ndërkohë që numri do të ketë rritje shumë të madhe për vitin tjetër.

Sa u përket ngjarjeve tona, sa për t’ju futur në temë, në përgjithësi, do të doja që së pari të shkëputemi nga përfytyrimi i një komisioneri ose i një institucioni të pavarur tipik. Në rastin tonë, siç jeni në dijeni, bëhet fjalë për një arkiv të madh. Anëtarët e nderuar të këtij komisioni kanë qenë në vend dhe e kanë parë. Bëhet fjalë për një fond të madh fizik. Shpenzimet e administratës janë me vete, por shpenzimet e arkivit, qoftë për hapësirat, qoftë për standardet e ruajtjes së një arkivi historie të nivelit europian, qoftë për sa i përket sistemeve për ruajtjen, përpunimin e të tjera, janë të tilla, sa që do të doja, zoti Fino, që ne të hiqnim një paralele për administratën me komisionerët, ndërsa për arkivin të ishin më vete në analizë.

Ngjarja tjetër e rëndësishme është që gjatë gjithë vitit 2019 kemi qenë nën presionin e një lëvizjeje sa i përket rregullimit të territorit. Bashkia Tiranë, me vendim të Këshillit të Ministrave, ka marrë në administrim godinën ku ne sot jemi si administratë, dhe na është kërkuar të bëjmë lëvizje të administratës, për arsye se godina ku ndodhemi sot, në ambientet e Gardës së Republikës, do të shembet.

Nga buxheti që kishim u munduam të linim disa fonde për shpenzime qeraje, por e kemi vonuar, që të ishim sa më eficientë, të mos bënim shpenzime të kota. Gjithsesi, me sa kemi bashkëpunuar me institucionin e bashkisë, vihet re se me siguri, vitin tjetër do të na kërkojë të shpërngulemi që aty. Prej këtu burojnë edhe nevojat tona për buxhete, që të akomodojmë arkivin dhe administratën.

Së pari, do të doja të bëja dy-tri komente të vogla sa i përket plan-buxhetit që ju keni dhënë. Vihet re një gjë pozitive, që stafi, nga 66 % që e kemi pasur, shkon në 83 % të strukturës së miratuar, ndonëse prapë vazhdojmë të jemi me mungesa. Nuk bëhet fjalë për një strukturë të re, po për një strukturë të paplotësuar. Pra, as vetë vendimi i parlamentit nuk është miratuar. Thashë, është një hap i vogël i mirë, sepse nga 66 % bëhemi 83 %, por mbeten 17 %, pra afërsisht edhe një dhjetëshe tjetër e paplotësuar.

Gjithsesi, në dhjetëshen e re që kemi marrë, kemi vënë re se mungojnë disa shpenzime për kontribute të sigurimeve shoqërore, por sidomos për mobilie dhe pajisje kompiuterike për stafin shtesë. Nuk janë shpenzime të mëdha. Kemi bërë edhe një tabelë të nevojave akute. Është fjala për 4, 5 milionë lekë, që kanë të bëjnë me sigurimet shoqërore për stafin shtesë, si dhe mallra e shërbime për të mundësuar ato.

Prapë koment për buxhetin. Vëmë re se një grant, të cilin e kemi përfituar nga qeveria suedeze, që e kemi nënshkruar dhe kemi marrë disbursimi e parë, nuk figuron këtu. Do të duhej të figuronte qoftë në buxhetin e 2019-ës, qoftë në PBA, deri në 2021-shin. Për t’ju futur në

temë, ne i kemi dërguar edhe më përpara marrëveshjen dhe modalitetet. Kemi përfituar vetëm sa i përket ambienteve të arkivit, që janë 30 % e ambienteve të përgjithshme. Ata marrin përsipër të financojnë edhe sistemet e ruajtjes nga lagështira të ambienteve fizike, të kamerave, të serverëve e këtyre gjërave, por nuk marrin përsipër fare të investojnë për administratën, gjë e cila mbetet me siguri detyrë e qeverisë.

Dy komente kemi. Disa shtesa të vogla për sa i përket personave shtesë që na keni dhënë, ndonëse shpresojmë shumë që të kemi dhjetëshen e plotë, pra të plotësohemi me staf. Po ashtu, të na mundësohet patjetër financimi shtesë për godinën. Financimi suedez heq arkivin, por zyrat dhe administrata mbeten. Bëhet fjalë për 50 milionë lekë. Nuk është diçka e pamundur. Është një institucion i ri, në ngritje. Janë shpenzime që bëhen vetëm një herë dhe nuk do të bëhen më. Është edhe efiçiente, sepse sa të shkojmë në ambiente me qira, gjë që është shpenzim i kotë, sepse godina është, investimet po bëhen. Do të ishte shumë e udhës që të fillohej menjëherë me këto investime. E kemi përgatitur edhe me shkrim.

Ulsi Manja – I kanë. Faleminderit, zonja Sula!

Zoti Fino, lidhur me institucionin e Autoritetit të Dosjeve.

Bashkim Fino – Në fakt, ky autoritet ka pësuar ndryshime që nga viti 2017 e në vijim. Janë ndryshime shumë rrënjësore në parametrat financiarë. Po të shikosh shifrat e 2017-ës e të 2018-ës, ka një ndryshim dhe një hap galopant. Kjo është për meritë të zonjës Sula, por edhe për mundësinë që i kemi dhënë ne si komision. Kemi bërë edhe një vizitë në godinën që Ministria e Mbrojtjes ju ka vënë në dispozicion, në mos gaboj. Është e vërtetë që ajo godina duhet të rikthehet në një autoritet shumë të rëndësishëm për dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Nga kjo pikëpamje, unë mendoj se buxheti duhet të jetë në funksion të edhe të asaj vizite që ne bëmë si komision, sepse s’e bëmë kot, por edhe në funksion të problematikave të tjera.

Tani, në lidhje me çështjen e parë, në qoftë se janë shtuar dhjetë vetë, dhe numri i punonjësve tuaj është pesëdhjetë vetë, numër i miratuar këtu, absolutisht që është detyrë numër një e Ministrisë së Financave dhe e drejtuesve tuaj financiarë, që fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore për pesëdhjetë vetë duhet të jetë diçka absolute. Domethënë, kjo nuk bëhet fjalë, por duhet thjesht një rakordim në përllogaritje, sepse përllogaritja që ka bërë Ministria e Financave, me përllogaritjen që kanë bërë financat tuaja, mund të mos rakordojnë. Mund të mos jetë tetëdhjetë e katër, mund të jetë tetëdhjetë e dy, mund të jetë edhe tetëdhjetë e pesë, pak rëndësi ka, por kjo është diçka e domosdoshme dhe nuk ha diskutim këtu. Edhe Moza që është këtu, apo unë, nuk e vëmë në diskutim. Nëse janë pesëdhjetë, pra po aq sa numri

i listës që shoh unë këtu, absolutisht që fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore duhet të jetë për pesëdhjetë vetë. Nuk diskutohet kjo.

Diskutimi këtu lind mallra e shërbime, 602-shi, dhe për investimet. Janë dy momente, të cilat ne duhet t'i shikojmë pak me kujdes. Për shpenzimet mallra 602, unë mendoj se është një shifër e konsiderueshme. Po të kemi parasysh se në 2018-ën ju kishit vetëm 9, 9 milionë lekë, në vitin 2019 keni 18 milionë lekë. Po kaq ju është planifikuar edhe për 2020-ën, shpenzime 602-shi. Madje, më lejoni t'ju them, meqë ju merreni me financat dhe ju njoh prej kohësh, në faktin e dhjetëmuorit, nga 18 milionë keni harxhuar vetëm 6 milionë. Kjo do të thotë se keni edhe 12 milionë shpenzime mallra dhe shërbime. Kjo do të thotë se 12 milionë ti nuk i harxhon dot kurrën e kurrës për muajt e mbetur nëntor, dhjetor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund ta bësh ndërhyrjen, por të dhënat këtu janë, zoti kryetar, duhet shpjeguar...

Bashkim Fino – Këta e kanë pasur 18 milionë shpenzime...

Ulsi Manja – Të mbarojë zoti Fino, zonja Sula.

Bashkim Fino – Nga 18 milionë shpenzime, që i kemi dhënë në 2019-n, në fund të tetorit, pra pa nëntorin dhe dhjetorin, këta kanë realizuar vetëm 6 milionë. Pra, nga 18-milionëshi, pa 6 milionë, mbeten edhe 12 milionë. E bëni vetë llogarinë ju.

Ndërkohë, planifikimi i Ministrisë së Financave është 18 milionë të tjera për 2020-n. Unë mendoj se e ka planifikuar mirë. Madje, mund të bëj pyetjen: pse e planifikon 18 milionë, kur këta në 10 muaj harxhojnë 6 milionë? Kam të drejtë ta bëjë këtë pyetje, apo jo?

Person f – Po.

Bashkim Fino – Nuk e di unë atë, a ka apo nuk ka...

Këtë gjë duhet ta zgjidhni me Ministrinë e Financave, por mendoj që 18-shen, që e ka planifikuar, nuk po ta ul. Unë nuk po them të ulet, absolutisht. Unë them të ngelet aq sa është, 18 milionë lekë të rinj shpenzime për vitin 2020.

Për sa i përket investimit, natyrisht, këtu anoj më tepër nga zonja Sula, sepse ne, bashkë me zotin Manja, kemi qenë prezentë në godinën që ka dhënë Ministria e Mbrojtjes. Ajo është një godinë që nuk ka nevojë të rregullohet nga jashtë, por ka nevojë për rregullime të brendshme.

Në qoftë se këta kanë marrë një fond nga fondi suedez, është shumë mirë për arkivin. Kjo është një ndihmë dhe një punë e mirë, që e ka bërë zonja Sula. Kjo na ndihmon edhe në buxhet, sepse imagjinoni ta kishim dhënë ne edhe fondin për rregullimin e arkivit! Do të ishte dyfish e trefish... Nuk ka arsye pse të mos japim disa fonde për adoptimin e asaj godine, të paktën me zyra me karton xhez, për punonjësit dhe për t'u ulur.

Mendoj që shifra 2 milionë e investimit është shumë e vogël, po të kemi parasysh vizitën që kemi bërë bashkërisht.

Duhet të bëni një rakordim, sepse është ajo që tha edhe zonja Sula, që investimi një herë bëhet dhe nuk mund të bëhet përherë. Pra, në qoftë se do të bëhen ato rregullime, kjo nuk ka ndër mend të kërkojë prapë vitin tjetër investime për zyrat. Mund të kërkojë për kompjuterë, për investime të vogla, siç u jepni të gjitha institucioneve, por jo investime kapitale për të rregulluar zyrat.

Këtë duhet ta shohim, sepse edhe kur kemi bërë vizita si komision, kemi marrë përsipër dhe kemi thënë: “Interesohu me fondin suedez, por edhe ne do të interesohemi kur të vijë buxheti, për të dhënë një fond të konsiderueshëm”.

2-milionëshi që keni vënë këtu, Moza, është thjesht për të blerë disa dollapë, tavolina e kompjuterë dhe asnjë gjë nuk mund të bëhet për rikonstrukcionin nga brenda, për rregullimin. Minimalisht, dritat dhe rregullimet e zyrave janë shumë të domosdoshme.

Nuk e di se sa e keni ju “hapin” për të dhënë dhe nuk e di (materialin nuk e kam lexuar, megjithëse e keni sjellë sot) sa janë shumat për një financim të tillë, por edhe me pjesë sikur të jepet, për mendimin tim, do të ishte një gjë shumë e mirë financimi i investimit për restaurimin e godinës së brendshme. Këtë koment kisha për projektbuxhetin e Autoritetit të Dosjeve.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Financa të bëjë një koment të shkurtër.

Vitori Fuqi – Doja të sqaroja për mosrealizimin e shpenzimeve operative në Autoritet. Në detajimin e buxhetit, që bëmë në fillim të vitit, një pjesë të madhe të fondit, rreth 7 milionë lekë të rinj, e vendosëm për marrjen e ambienteve me qira, sepse Garda nuk na dhënë asnjë lloj shkrese për ta përdorur atë ambient dhe bashkia na ka sjellë shkresë që duhet të zhvendosemi sa më shpejt. Erdhëm në fund të vitit dhe nuk e harxhuam fondin. Menduam ta riallokojmë në shpenzime të tjera, që mund t’i realizojmë momentalisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi prokurimet. Kemi bërë riallokime brenda shpenzimeve të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë shpenzime operative.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me grupin e menaxhimit strategjik.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po...

Gentiana Sula - Ideja ishte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I kemi të zgjidhura të gjitha, zoti Fino.

Bashkim Fino – ...se ti ke realizuar 6. 6,7 janë zyra. Tani të bëjmë aritmetikë...

(Deputeti Bashkim Fino flet pa mikrofon)

Vitori Fuqi – Atë fond ne e kishim planifikuar...

Ulsi Manja – Zonja Sula, ju lutem...!

Gentiana Sula – Ne donim të kursenim qiranë, se edhe mund të dilnim me qira në ambiente luksoze, por menduam... Mirëpo, deri në çastin e fundit...

Ulsi Manja - Ju lutem, se çfarë keni bërë për 2019-n dhe çfarë keni menduar...! Kanë ngelur edhe pak ditë dhe do të ndahemi me 2019-n. Sot jemi për atë që do të ndodhë në 2020-n.

Tani, që të jemi edhe një herë të qartë se çfarë propozon kolegu, zoti Fino, si relator për institucionin: të mbyllet dhe të rakordohet fondpaga plus sigurime shoqërore për gjithë personelin që keni dhe që është shtuar në institucionin tuaj. Pra, të mos diskutohet më fondi i pagave plus sigurimet shoqërore, sipas tabelës që keni kërkuar. Të rakordohet deri në miratimin e buxhetit në parim dhe nen për nen me Ministrinë e Financave.

Vitori Fuqi - Kam edhe një koment, zoti kryetar.

Bëhet fjalë për një rekomandim të rezolutës suaj për vitin, ku ju kërkoni të bëjmë një sistem të menaxhimit të rasteve...

Ulsi Manja - Të lutem, se i kam në radhë të gjitha!

Vitori Fuqi – Ideja është që po nuk morëm financim, nuk e bëjmë dot.

Ulsi Manja -Ideja është që po nuk më le të mbaroj, nuk do t'i marrësh. Paga plus sigurimet shoqërore është çështje e mbyllur.

Zonja Dhëmbi, relatori propozon: paga plus sigurime shoqërore për stafin e Autoritetit për vitin 2020.

Për mallra dhe shërbime të tjera, e keni 18. Keni kërkuar 23 milionë. Zoti Fino, ngelet vlera që është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, për 2020-n ngelet kjo që është.

Bashkim Fino – Tri janë kërkesat që ne mund t'i realizojmë.

Kërkesa e parë është e realizueshme, por po e themi për efekt procesverbali. Fondi i pagave dhe sigurimet për 50 punonjësit, absolutisht, duhet të jetë i sakët.

Ulsi Manja – Është i mbyllur.

Bashkim Fino – Pra, del 84 apo del 86, pak rëndësi ka! Duhet të jetë i saktë.

Shpenzimet operative, mallra e shërbime, të ngelet 18, siç është parashikuar nga Ministria e Financave. Pavarësisht debatit që bëra, realizohet apo nuk realizohet, shpresoj që vitin tjetër t'i realizojnë këto shpenzime.

E treta dhe më kryesorja, ku duhet të jemi të gjithë në një mendje, drejtoresha këtu ka paraqitur tre zëra: blerje pajisjesh informatike, 3,5 milionë; blerje mobiljesh zyre, 2,5 milionë, si dhe përshtatje zyre, 35 milionë.

Mendoj që kjo e fundit është e domosdoshme të vihet në projektbuxhetin e vitit 2020, pra përshtatja e zyrave, ajo që kemi parë bashkërisht...

Ulsi Manja – Biem dakord edhe për këtë.

Bashkim Fino - ...që ishte hapane e madhe. Duhet të përshtatet...

Do të më dëgjoni? Se për ju po flas.

Ulsi Manja – Do të biem dakord për këtë.

Bashkim Fino - 35-milionëshi duhet të vihet, plus 2-milionëshin, që e ka vënë këtu Ministria e Financave. Është mirë të ngelet për shkak të blerjes së disa mobiljeve të zyrave. Të paktën, si institucion, nuk do të na vijë të na kërkojë prapë vitin tjetër investim për këtë. Mund të na kërkojë pajisje informatike, por nuk do të na kërkojë më për përshtatje zyre.

Ulsi Manja – Biem dakord edhe për këtë gjë.

Bashkim Fino – Unë jam dakord 35 milionë plus 2 milion, që është *gia*, por 35-milionëshi vetëm për përshtatje të zyrave dhe rregullim të brendshëm. Është shumë e domosdoshme të bëhet.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Fino!

Edhe unë jam dakord me sugjerimin e zotit Fino.

Ka te 231-shi, sistemi i menaxhimit të çështjeve... Ka kërkuar, sipas kësaj tablele, 13 mijë e 500.

Kjo nuk miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Sula, besoj se jeni e qartë.

Gentiana Sula – Dakord.

Ulsi Manja – Fond pagash plus sigurime. Për mallra dhe shërbime ngelet ajo që është parashikuar nga Ministria e Financave, ndërsa në zërin e investimeve, të furniturave, blerje, pajisje, rikonstrukcion zyrash, 35 plus 2, siç propozoi relatori Fino.

Ministria e Financave, së bashku me zyrën e financës së Autoritetit të Dosjeve, të bëjë rakordimet e duhura për të gjitha këto që u dakordësuar sot në komision dhe para se ta çojmë

raportin në Komisionin e Ekonomisë dhe pastaj për ta votuar në Kuvend, të dihet çfarë i dhamë Autoritetit të Dosjeve.

Jam plotësisht dakord që ajo godinë, që ne e vizituam në kuadrin e mbikëqyrjes parlamentare me kolegët e mi të komisionit, të kthehet në një godinë dinjitoze për një institucion dinjitoz, që me ligj i kemi dhënë të drejtën të zbardhë të kaluarën tonë 50-vjeçare, për të cilën jam i bindur që ky komb e meriton të zbardhet.

E rëndësishme është që institucioni është rishtaz i ri, ka vështirësitë e tij, si çdo institucion i krijuar, ka vështirësitë e tjera të punës, që lidhen me arkivin dhe me çfarë memorie administron ky institucion. Është shumë e rëndësishme që i gjithë arkivi atje, i Ministrisë së Brendshme, të shkolla lart (nuk po flas për arkivin e sistemuar, që është pranë Shërbimit Informativ Shtetëror), një orë e më parë dhe, në mos gaboj, rreth 30 milionë dokumente, të jetë pjesë përbërëse e asaj godine, që meriton të ketë një arkiv të sistemuar.

Shumë faleminderit për prezencën sot në komision, të gjithëve pa përjashtim, komisionerëve dhe stafit mbështetës të Autoritetit të Dosjeve!

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Kalojmë tek institucioni i fundit për sot, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pashkallëve të Komunizmit.

Sot kemi prezent zonjën Zoica Graçi, financiere.

Mirë se erdhët në komision!

Ju lutem, shumë shkurtimisht, flisni për nevojat buxhetore të institucionit tuaj, sa janë akomoduar ato nga Ministria e Financave dhe çfarë kërkon nga ne!

Zoica Graçi – Përshëndetje!

Mirë se ju gjeta!

Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit është i kënaqur me buxhetin e alokuar për vitin 2020, si dhe me numrin e punonjësve, me shpenzimet e pagave, të sigurimeve shoqërore dhe shpenzimet operative.

Nuk kemi kërkesa shtesë për vitin 2020.

Shumë faleminderit!

Ulsi Manja – Zoti Fino...

Bashkim Fino – Të vetmin problem që kemi pasur gjatë viteve (madje, morëm edhe një iniciativë me kolegun Adnand Shemeti) e kemi pasur për strukturën e institutit, e cila, duke u varur nga ne, duhet të miratohet nga ne, sepse ne e miratojmë numrin. Ne kemi miratuar 19 vetë. Me sa duket, është zgjidhur problemi për 19 veta, pra edhe fondi i pagave është për 19 veta...

Zoica Graçi - Po, para 20 ditësh ky komision e miratoi ndryshimin e nenit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino - ...Kjo do të thotë se në momentin kur është zgjidhur problemi dhe ngërçi, që ky institucion kishte 14 veta, u shtuan 5 veta dhe tani numri ka vajtur 19, ka fond page për 19 veta, shpenzimet e investimet i ka në rregull dhe mendoj që edhe buxheti është plotësisht në rregull, por duhet të bëjmë vetëm një ndryshim, që është një iniciativë, që e kemi marrë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, që të bëjmë vetëm thjesht ndryshimin e strukturës për këtë numër, që e kemi *gia* në buxhet dhe nuk kemi ndonjë gjë... Kështu që, ngelemi të kënaqur.

Dakord?

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Fino!

Shumë faleminderit zonja Graçi!

Nisma ligjore për ndryshimin në ligj është depozituar, është në Kuvend dhe do ta kalojmë shumë shpejt.

Punë të mbarë!

Zoica Graçi- Faleminderit edhe ju!

Punë të mbarë!

Ulsi Manja – Me dëgjesën me Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, të nderuar kolegë, e mbyllim për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Nesër do të kemi institucionet e fundit, që do t'i dëgjojmë për buxhetin e vitit 2020.

Shumë faleminderit për prezencën dhe durimin!

Shumë faleminderit edhe medieve për pasqyrimin e kësaj seance të gjatë të mbledhjeve të komisionit!

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

